



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 33

Datë: 16. 05. 2024; Ora: 10:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Mufera Shinik, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, krye shëf i SKQZ. Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyesë: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes Nr.32 /2024**
- 3. Aktivitetet e Zyrës**

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për regjistrimin e partisë politike: ROMANI INICYATIVA.

4. Raport i Këshillave të KQZ

5.1. Këshilli për Buxhet dhe Financa

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Buxhetit për organizimin e takimeve të KQZ-së me Kryetar të Komunave dhe me Kryesuesit e Kuvendeve Komunale;

5.2. Këshilli për Operacione Zgjedhore

1. Shqyrtimi i Agjendës për punëtorinë për mësimet e nxëna për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave në Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut dhe përgatitjet për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Specifikave për furnizim me kamera në vendvotim;
3. Organizimi i takimeve të KQZ-së me Kryetar të Komunave dhe me Kryesuesit e Kuvendeve Komunale:

7. Të ndryshme !

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Në fillim të mbledhjes, kryetari Radoniqi paraqiti rendnin e ditës dhe pyeti anëtarët, se a kanë të propozojnë ndonjë pikë tjetër. Alban Krasniqi, tha se propozoj që të futet si njoftim pika që ka të bëjë me çarkoren buxhetore, dhe pika tjetër ka të bëjë me atë se jemi informuar nga OSBE që është përzgjedhur kompania për zhvillimin e platformës digjitale për informim dhe edukim të votuesve. Të caktohet një ekip nga Sekretariati, dhe i njëjti të informoj në KOZ dhe në KQZ. Pra, ideja është me e forume këtë ekip...

Kreshnik Radoniqi: Me këto dy pika, a ka dikush tjetër ?

Sami Kurteshi, propozoi edhe një pikë “Në të ndryshme!”.

Me 8 vota për, u miratua rendi i ditës. Në vazhdim, me 8 vota për u miratua edhe procesverbali nr. 32/ 2024.

2. Aktivitetet e Zyrës

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për regjistrimin e partisë politike: ROMANI INICYATIVA:

Besnik Buzhala, drejtor i zyrës, paraqiti rrjedhën e aplikimit të iniciativës politike “Romani iniciativa”, bazuar në kornizat ligjore për zgjedhjet dhe rregulloret e KQZ-së. Edhe ky subjekt, ka përfaqësuesit e vet në Parlamentin e Kosovës, dhe nuk i nënshtrohet nënshkrimeve dhe pagesës së taksës. Iniciativa, ka ndjekur të gjithë hapur, dhe zyra po ashtu e ka kompletuar dosjen dhe rekomandon për regjistrim.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për...?

Me 8 vota për, u regjistrua ky subjekt i ri politik në KQZ me nr. 52.

Arianit Elshani, pyeti se deri kur është afati sepse sipas ndryshimeve të ligjit të zgjedhjeve dhe rregulloreve zgjedhore të KQZ-së iniciativat në Kuvend, duhet të regjistrohen. Pra, sa janë të tjera ?

Besnik Buzhala: Dy janë paraqitur, pra janë regjistruar. Edhe pse ka kaluar afati, është edhe një iniciativë: Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës. Ata e kanë njoftimin e Zyrës, por ky subjekt parlamentar, ende nuk e ka marrë asnjë veprim, edhe pse afati prej 60 ditë, kanë kaluar. Veprimin e fundit, do ta bëjmë javën e ardhshme...

Kreshnik Rdoniqi: Lidhur me çarkoren buxhetore...?

Burim Ahmetaj, tha se SKQZ me më 15 maj, ka pranuar farkoren nga MF. Në bazë të kornizës, pra të çarkore, janë edhe kufijtë buxhetorë. Sipas kësaj çarkore, për kategorinë paga dhe mëditje janë planifikuar për 93 zyrtarë, kurse ne kemi planifikuar për 108 zyrtarë. Pra, është minus për 15 zyrtarë të planifikuar nga KQZ. Në vazhdim, z. Ahmetaj elaboroi diferencat e mjeteve materiale të planifikuar nga KQZ, në diferencë me çarkoren e adresuar nga Ministria e Financave. Ai, tha se Sekretariati ka filluar të e përgatisë edhe buxhetin për vitin 2025, ku referencë është edhe korniza afatmesme e shpenzimeve. Kjo, do të trajtohet edhe në KOZ, po edhe në Këshill të Buxhetit. Materialet i keni në imell...

Alban Krasniqi: Në shkresë, a janë dhënë arsye specifike të këtyre dallimeve, a janë analizua justifikimet nga Ministria, apo janë në kornizën e përgjithshme...?

Burim Ahmetaj: Po, korniza është e përgjithshme ku specifikohen kufijtë për secilën organizatë buxhetore, madje për secilën kategori...Te ne, janë 3 kategori ku janë vënë kufijtë më të reduktuar, se planifikimet që kemi ba ne...

Arianit Elshani, e para, kur kërkohen mjetet financiare, në këtë rast nga KQZ, bëhen edhe arsyetimet e kornizës buxhetore. E kemi diskutua këtu në Sekretariat nga stafi, pra projektet e domosdoshme, dhe dy proceset zgjedhore që janë të planifikuar në vitin 2025. Kërkesa jonë, ka qenë e planifikuar. Pra, a keni marrë arsyetim se, pse nuk janë aprovuar, pse është vendosur ky kufi...? Kjo, duhet me u analizue në KOZ dhe të komunikohet brenda këtij muaji me MF.

Sami Hamiti, tha se Korniza Afatmesme të Shpenzimeve dhe Kufijtë Buxhetorë analizohet në MF. Ne, disa kërkesa me vite si kemi plotësua. I kemi planifikue do vende të lira, nuk i kemi realizue...! Pra, nuk qiten si projeksion më tej, ata i kanë pa, i kanë analizue...Kështu është edhe te shërbimet dhe mallrat...

Nuk e shkurtojnë buxhetin, por si kemi bërë shpenzimet qysh duhet, si kemi shpenzue planifikimet. Pjesa që është për zgjedhje, nuk do të mungojë, por ne duhet të jemi planifikues më të mirë. Ne, duhet të jemi më planifikues...

Në këtë pikë, diskutuan edhe: Alban Krasniqi, Sami Hamiti.

3. Raport i Këshillave të KQZ

5.1. Këshilli për Buxhet dhe Financa

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Buxhetit për organizimin e takimeve të KQZ-së me Kryetar të Komunave dhe me Kryesuesit e Kuvendeve Komunale:

Gordana Llaban: Kemi shqyrtuar projektin e takimeve të KQZ –së me kryetarët e komunave dhe përfaqësuesit e KKZ-ve të komunave. Me këtë rast, janë shqyrtuar shpenzimet, të cilat kapin vlerën 1560 euro. Rekomandojmë miratimin e këtyre mjeteve.

Me 8 vota për, miratohet plani i buxhetit të takimeve të KQZ me kryetarët e komunave.

4. Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi i Agjendës për punëtorinë për mësimet e nxëna për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave në Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut dhe përgatitjet për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës:

Arianit Elshani, tha se ky projekt është miratuar në mbledhje e kaluar për mbajtjen e kësaj punëtorie për mësimet e nxëna për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave në Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut dhe përgatitjet për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës. Në diskutime publike, është sensibilizue edhe kjo çështje, dhe për ne implikon përgatitjen e një plani edhe për zgjedhjet parlamentare. Kemi ligjin, rregulloret e reja, si dhe ndryshimet që reflektohen në aktivitetet tona, kemi formuluar një agjendë për përgatitje. E keni agjendën...

Alban Krasniqi, tha se nga udhëzimet që i kemi bërë për Sekretariatit, a janë bërë prezantime, a na janë dërguar draft – prezantimet. Mendoj që, ne duhet ti kemi paraprakisht...Pra, një informacion se kush i ka përgatitur, e kush jo, sa janë përgatitur e sa nuk janë...

Burim Ahmetaj: Sot, marrim masat që çdo gjë të jetë gati.

Sami Hamiti: Për informim dhe edukim të votuesve, kush prezanton...?

Burim Ahmetaj: Udhëheqësi i DOZ...

Me 7 vota për, u miratua agjenda e kësaj punëtorie.

Shqyrtimi dhe miratimi i Specifikave për furnizim me kamera në vendvotim:

Arianit Elshani: E kemi shqyrtuar edhe këtë aktivitet (Specifikat për furnizim me kamera në vendvotim) që, tashmë e kemi këtë aktivitet në rregullat tona, ashtu si edhe në ligjin për zgjedhje. Kamerat, vendosja e tyre, tha z. Elshani, do të përdoren në zgjedhjet e ardhshme: lokale, e parlamentare. Shuma e planifikuar, është 1 milion e 50 mijë euro. Ky dokument, është trajtuar në disa mbledhje. Janë dhënë komentet, reagimet, analizat...

Sami Kurteshi, shtroi pyetje nëse, kamerat mund të sigurohen po qe se ka zgjedhje brenda dy muajsh ? Cili është formati teknik i tyre ?

Arianit Elshani, tha se procedurat do jenë publike, të prokurimit por është e pamundur që kjo të realizohet shpejt. Ai, foli edhe rreth cilësisë së kamerave, modelit etj.

Me 8 vota për, miratohen specifikat për furnizim me kamera në vendvotim.

Organizimi i takimeve të KQZ-së me Kryetar të Komunave dhe me Kryesuesit e Kuvendeve Komunale:

Arianit Elshani, tha se ky diskutim, është aktual qe sa muaj, dhe KOZ ka diskutuar, e ka realizuar dhe mendojmë që KQZ të filloj javën që vjen takimet. Secilit zyrtar, u është dërguar kërkesa që ata të shqyrtojnë nevojën për një qendër numërimi për secilën komunë. Pra, votat do të numërohen në komuna, dhe jo në QNR. Por, duhet diskutojmë edhe me kryetarët e komunave si t'a implemetojmë projektin, mbështetja e tyre...

Në parim, rekomandojmë që të miratohet

Në këtë pikë, diskutuan: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, të cilët thanë se duhet pasur një plan të detajuar të vizitave, një agjendë konkrete, tabelë e agjendës, vendtakimet, ekipi i takimeve etj.

Në vazhdim të mbledhjes, u diskutua lidhur me përzgjedhjen nga OSBE të kompanisë për zhvillimin e platformës digjitale për informim dhe edukim të votuesve.

Në këtë pikë, diskutuan: Arianit Elshani, Alban Krasniqi, Burim Ahmetaj.

Pas shqyrtimeve, u propozua ekipi:

1. Visar Kastrati, udhëheqës i ekipit.
2. Azemine Beqiri.
3. Valbona Kida.
4. Nita Mustafa.
5. Valmir Elezi.
6. Enisa Basha.

5. Të ndryshme!

Sami Kastrati, tha se ka ardhur një letër nga BE, por do ta diskutoj në punëtori. Edhe komitetin e auditimit, takimin e kemi mbajtur. Do të sjellim raport në mbledhje të KQZ...

Kemi marrë një ftesë nga Rrjeti Elektoral Nacional Frankofon për një trajnim. Mbahet në gjuhën frëngjishte. Zgjatë nja tetë muaj. Afati për regjistrim, është deri më 24 qershor.

Arianit Elshani, tha se kam kuptua që bëhet fjalë edhe për përfaqësues të subjekteve politike, të organizatave civile etj. Meqë, janë 30 bursa që ndahen, dhe pse jo, ka të rijnë që mund ta shfrytëzojnë këtë mundësi...

Diskutuan, edhe: Alban Krasniqi, Sami Kurteshi.

Në vazhdim, Alban Krasniqi shpjegoi se janë dy çështje: raporti që ka të bëjë me punën e Komisionet me Sistematizim, dhe raporti që ka të bëjë me lëndët që janë pjesë e procesit gjyqësorë. Janë çështje, ne duhet ti diskutojmë, s'është me rëndësi kush apo, qysh ? Por, duhet të jenë në raport, dhe ne në mbledhjen e ardhshme duhet ti diskutojmë. Po ashtu, nuk janë pague ende KKZ-të. Vonesat e tilla, janë problem serioz. Nuk mund të pritët dy-tre muaj për pagesë...

Shkurt, edhe një çështje: i kam pa tri-katër gjykime të gjykatave. Janë vendime lirimi, dhe kjo është shqetësuese. Mbrojtja nga ana jonë, a problematike. Ku kemi marrë ne pjesë, përfaqësuesit ku ne kemi marrë pjesë ne, keqbërësit, manipulatorët janë amnistu...

Kjo i bjen që, KQZ ka manipuluar, ka gënjyer...! Kur shihen këto vendime të gjykatave, në disa raste ne kemi qenë palë e dëmtueme. Parimi ynë është me ndjek rastin deri në fund, pra, duhet një raport...Nuk e di çka jemi duke mbrojtë ne...

Burim Ahmetaj: Deri më 31 korrik, po ua kujtoj se është afati i konkursit për nënkryetar të AËEB. Kolumbia, e ka përfaqësuesin e kryetari. Konkursi, është për nënkryetar.

Arianit Elshani, tha se në bashkëpunim me KQZ e Shqipërisë, me z. Cilibashi dhe të diskutohet, të bashkëpunohet e harmonizohen veprimet. Dhe, të shihet kjo sepse është mirë të komunikohet, të ketë një organizimin të përbashkët...

Alban Krasniqi: E para, është mirë me u takue, me pa si shkon, cilat janë përparësitë, sfidat...